



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Malsijaj Company” Sh.P.K. të datës 19.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me nr. të prokurimit 616-22-11453-2-1-1 dhe me nr. të brendshëm 616 22 175 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Malsijaj Company” Sh.P.K. e datës 19.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me nr. të prokurimit 616-22-11453-2-1-1 dhe me nr. të brendshëm 616 22 175 211.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Malsijaj Company” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Malsijaj Company” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 19.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me nr. të prokurimit 616-22-11453-2-1-1 dhe me nr. të brendshëm 616 22 175 211. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritu*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 5

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): "Në deklaratet mbi eliminim ju keni cekur se ishim të papërgjegjshëm për shkak të makinerisë të ofruar. Dhe kinse nuk kemi garancion për 12 muaj. Dhe mostra e ofruar. Fillimisht mostren kemi ofruar 2 orë para hapjes të tenderit. Mostër e cila është prodhuar sipas standardeve të kërkuara. Paisjet ishin gjithëashtu se cila në vend kur ishit në verifikim. Nuk është kërkuar të punohet me ato paisje. Po edhe të jet nevoja të dëshmohet si punohet me paisje, ne do jemi në gjendje ti demostrojm edhe në atë menyra paisjet tona. Si dhe sa i përket garancionit, ne kemi garantuar oër 12 muaj në lidhje me të gjitha produktet që do ti prodhojm. Kjo deklarat gjindet ne Dosjen e ngarkuar nga ne. Këtu shihet se nuk është bërë vlerësimi sipas ligjit".

Pretendimi i dytë (II): "Gjithëashtu ju keni shpallur fitues një OE. I cili ka disa dokumenta të dyshimta, si dhe një pjesë e dokumentacionit i mungon. Fillimisht Ing. Flori Cikaçi, nuk ka fare referenc. Si dhe të vështrohet mir nënshkrimi në cv dhe në kontrat, është tejet i dyshimt. Arsyeja se ky dokument nuk është marrë nënshkruar dhe vulosur. Pastaj skenuar nga origjinali. Është marr vulja e skenuar dhe vendosur së pari në dokument word, si dhe nënshkrimi është shkëputur nga ndoni dokument dhe vendosur në të njejtën form si kontrata. Kjo që tham mund të verifikohet pa problem. Pos kësaj këta që kanë ofruar deklaratë të garancionit për 12 muaj, është fare nga një kompani me të cilën nuk figuron marrëveshje bashkpunimi me kompanin fituese. Pos kësaj IDK nuk është prodhuar, dhe mbi gjitha ky ka aplikuar edhe për vete si konsorcium me TSR. Nëse ashtu siq është cekur në raportin e vlerësimit që as TSR&IDK nuk ka garancion për 12 muaj, si mund të ketë kompania Fituese të ketë një garancion, nga një kompani e cila ka bashkpunim me IDK. Pastaj kompania Nouva ka ofruar një garancion për prodhim gjithëashtu tek ky OE, nuk ka ndoni marrëveshje nga kjo kompani me OE fitues, që me dit se kjo kompani a është bashkëpunëtor, apo është marrë dokumentacioni i saj, pa u njoftuar hiq kompania Nouva. Përveq garancionit të ofruar nga kjo kompani është ofruar edhe certifikata UNE 1436 Dhe për këtë nuk është dashur të llogaritet se ky OE posedon certifikaten UNE 1436, dhe garancionin e punimeve. Oe fitues nuke ka të nënshkruar Aneksin 1, që janë specifikat teknike. Nuk ka ndoni deklarat se i pranon ato".

Pretendimi i tretë (III): "Pos asaj ne kemi vërrejtur edhe disa fatura fiktive, kur kemi kontaktuar kompanin që ka lëshuar faturat janë paraqitur si kompani e sigurimeve. Kompania ALPEN nr i biznesit 70693666, në fatur është përshkruar një nr. me gabim teknik Fatura 001199,; fatura 001192; fatura 001186; dyshohen si fiktive".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 2, 7 dhe 59 të LPP.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 23.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parë (I): fillimisht duhet potencuar që ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimi i tenderëve në këtë aktivitet të prokurimit është realizuar nga një komision profesional dhe objektiv i bërë nga anëtar të fushës sipas LPP në fuqi. Këtë fakt si të tillë nuk e ka kontestuar as vet parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim.

Tutje duhet cekur që komisioni vlerësues ka gjetur se parashtruesi duhet eliminuar si i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

1. **Arsyeja e parë:** Nuk ka dorëzuar deklaratën e garancionit nga prodhuesi për 12 muaj,
2. **Arsyeja e dytë:** A-testi nuk është sipas DT - nenit 13 par. 4 për gjuhët zyrtare;
3. **Arsyeja e tretë:** Mostrat nuk janë dorëzuar sipas kërkesës,
4. **Arsyeja e katërt:** Nuk janë prezantuar dhe nuk janë testuar makineritë me rastin e vizitës së komisionit në vendpunishte.

Të njëjtat arsye për eliminim si të tilla janë evidentuar edhe në njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues.

Së pari, duhet pasur parasysh që parashtruesi pretendimin e vet e ka orientuar vetëm kundër arsyes së parë, të tretë dhe të katërt për eliminim. Sa i përket arsyes së dytë lidhur me A-testet dhe nenin 13 par. 4, parashtruesi nuk ka prezantuar asnjë pretendim ankimor dhe në fakt këtë çështje nuk e ka përmendur fare në kërkesën e tij për rishqyrtim. Rrjedhimisht për parashtruesin nuk është kontestuese kjo çështje (dmth ai pajtohet me arsyen e dytë), pavarësisht faktit që vetëm një nga arsyet më sipër (në rastin konkret e dyta) ka mjaftuar për eliminimin e tij si të papërgjegjshëm. Sidoqoftë, nga administrimi i dokumenteve me të cilat ka ofertuar parashtruesi është arritur që të konfirmohen të gjeturat në raportin e komisionit të vlerësimit si dhe të njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues. Sa i përket garancionit sipas dosjes së tenderit në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është përcaktuar se "Deklarata e garancionit është e obligueshme nga prodhuesi për 12 muaj". Shih më poshtë:

Deklarata e garancionit i obligueshëm nga prodhuesi 12 Muaj për sinjalizim horizontal për ngjyrë mas plastike dhe sinjalizim vertikal.

Deklarata e garancionit nga prodhuesi

Parashtruesi e ka dorëzuar një deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur nga vet ai mirëpo nuk e ka dorëzuar deklaratën e garancionit nga prodhuesi për 12 muaj sikurse është kërkuar me DT. Për më tepër as me kërkesën e tij për rishqyrtim parashtruesi nuk e ka dëshmuar se e ka dorëzuar këtë dokument sipas DT. Në fakt edhe formulimi i pretendimit po të analizohet me kujdes, parashtruesi fare nuk e konteston që deklarata e garancionit është lëshuar nga vet ai dhe jo nga prodhuesi. Tutje sa i përket makinerive, komisioni vlerësues ka dalur në terren dhe me rastin e vizitës në vendpunishten e parashtruesit nuk kanë prezantuar dhe nuk janë testuar këto makineri sipas kërkesës së komisionit vlerësues. Parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim as që ka tentuar të argumentoj të kundërten e kësaj gjendje faktike mirëpo vetëm është shprehur se tani e tutje komisioni mund të vjen dhe të evidentoj posedimin dhe testimin e këtyre makinave. Mirëpo kuptohet se në këtë fazë të aktivitetit të prokurimit ky veprim nuk mund të ndërmerret sepse do të ishte në kundërshtim të plotë jo vetëm me dosjen e tenderit por edhe me LPP dhe RRPP në fuqi. Ngjashëm, parashtruesi nuk ka arritur as të argumentoj pjesën e pretendimit lidhur me mostrat e dorëzuara në kundërshtim me kërkesat e DT. Rrjedhimisht ky pretendim i parashtruesit është pretendim i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) dhe të tretë (III): duhet theksuar që parashtruesi një pjesë të këtyre dy pretendimeve nuk e ka drejtuar kundër tenderuesit të rekomanduar "Select Prima" Sh.P.K. për kontratë por i ka drejtuar kundër një tenderuesi tjetër të eliminuar si të papërgjegjshëm i cili është GOE "TSR Sh.P.K. & IDK Konstruktion Sh.P.K". Fjala është për pjesët e pretendimeve ku përmendet operatori ekonomik "TSR" dhe pastaj operatori ekonomik "IDK". Sa i përket kësaj pjese të pretendimve parashtruesi nuk ka dëshmuar asnjë interes material në raport me pretendimet e tij pasi që parashtruesi pretendon që ka gjetur se GOE "TSR Sh.P.K. & IDK Konstruktion Sh.P.K" nuk i plotëson kriteret sipas dosjes së tenderit. Në anën tjetër pikërisht për këtë arsye i njëjti tanimë është eliminuar si i papërgjegjshëm. Për më tepër edhe vet parashtruesi është gjetur nga komisioni vlerësues se është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit. Prandaj duke e qenë i papërgjegjshëm për vete, pretendimet e parashtruesit kundër një tenderuesi po ashtu të eliminuar si të papërgjegjshëm, nuk manifestojnë asnjë kuptim ligjor apo logjik. Me fjalë të tjera parashtruesi nuk ka dëshmuar se është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP ku përcaktohet se "*Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar*".

Sa i përket pjesës tjetër të pretendimit "*Fillimisht Ing. Flori Cikaçi, nuk ka fare referenc. Si dhe të vështrohet mir nënshkrimi në cv dhe në kontrat, është tejet i dyshimt*", së pari është me rëndësi të thuhet se parashtruesi nuk ka arritur që të artikuloj në mënyrë të plotë dhe konkrete pretendimin e tij por vetëm ka thënë se nënshkrimi në CV dhe kontratë "*është tejet i dyshimt*". Njëkohësisht nuk ka treguar pse është i dyshimt ky nënshkrim, mbi cilat argumente apo dëshmi e bazon ai këtë dyshim të tij, cilat dispozita të LPP apo të DT apo të RRPP janë shkelur nëse vërtetohet dyshimi i tij, etj. Në këtë kontekst edhe kjo pjesë e pretendimit të parashtruesit është jo vetëm e paartikulluar saktë dhe konkretisht, por edhe pa mbështetje ligjore apo logjike.

Sa i përket pjesës së pretendimit ku thuhet "*Fillimisht Ing. Flori Cikaçi, nuk ka fare referenc*", parashtruesi nuk ka arritur të shpjegoj se "*kush është Flori Cikaçi, për çfarë reference e ka fjalën dhe çka nënkupton kjo gjendje faktike që e pretendon ai respektivisht për cilën kërkesë të dosjes së tenderit po bëhet fjalë apo për cilat dispozita të LPP apo të RRPP është fjala*". Pra sërish parashtruesi nuk ka arritur që artikuloj në mënyrë të plotë dhe konkrete pretendimin e tij. Sidoqoftë nga hulumtimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar dhe nga administrimi i dosjes së tenderit si prova materiale në këtë rast, është gjetur se sipas dosjes së tenderit në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ndër të tjera është kërkuar edhe një (1) teknik i komunikacionit rrugor për të cilin është dashur të dëshmohet me CV, Kopje të Diplomës, Kontratë të punës ose marrëveshje për angazhim. Pra askund nuk është kërkuar referenca në këtë rast. Shih më poshtë:

Ekipa për punimet në sinjalizimin Horizontal dhe vertikal

1 (Një) Menaxher i projektit inxhinier të komunikacionit apo bachelor rrugor,

**1 (Një) teknikë të komunikacionit rrugor,
6 (Gjashtë) punëtorë,**

Për inxhinieret CV-a, Kopja e Diplomës, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Për punëtorët tjerë lista e stafit me CV, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt

Tenderuesi i rekomanduar në emër të kësaj kërkesë të DT ka prezantuar punonjësin me emrin Flori Cikaqi të cilin e potencon edhe parashtruesi në pretendimin e tij. Prandaj nëse parashtruesi sipas pretendimit të tij ka aluduar te kjo kërkesë e dosjes së tenderit, atëherë mund të thuhet se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar të gjitha dëshmitë dokumentare që janë kërkuar për këtë kërkesë të DT (një teknik të komunikacionit rrugor). Këtë fakt e ka e evidentuar komisioni i vlerësimit përmes raportit vlerësues mirëpo ky fakt mund të konfirmohet edhe përmes dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë dhe i tretë i parashtruesit janë pretendime të pabazuara në tërësi.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.06.2023


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 5 nga 5

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net